



VENDIM

Nr. 156, Datë 06.10.2016

**PËR
LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “XHENGO ENERGJI” SH.P.K, NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Ne mbeshtetje te neneve 16; 37, pika 2, germa “ç” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 21 te “Rregullores per procedurat dhe afatet per dhenien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave ne sektorin e energjise elektrike” te miratuar me Vendimin e Bordit te ERE-s, Nr. 109, date 29.06.2016; nenit 15 të “Rregullores per Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, date 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin per licensimin e shoqerise “XHENGO ENERGJI” sh.p.k, ne aktivitetin e Furnizimit te Energjise Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ere në “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pikat 4/9 gërma ‘a’, gërma ‘b’ dhe gërma ‘c’ është plotësuar në mënyrë korrekte.

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “XHENGO ENERGJI” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI